



Komisioni
Evropian

STRATEGJIA E BE-SË PËR RAJONIN ADRIATIKO-JONIAN

Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR) u miratua nga Komisioni Evropian dhe u certifikua nga Këshilli i Evropës në vitin 2014, duke e bërë atë strategjinë e tretë makro-rajonale në BE.

Strategjia përfshin **8 vende**, 4 shtete anëtare të BE-së dhe 4 vende kandidatë ose kandidatë të mundshme të BE-së, duke mbuluar një zonë ku jetojnë **70 milionë banorë**:

4 shtete anëtare të BE-së: Kroacia, Greqia, Italia (Abruzzo, Basilicata, Provincia Autonoma di Bolzano/Bozen, Calabria, Emilia-Romagna, Friuli-Venezia Giulia, Lombardia, Marche, Molise, Puglia, Sicilia, Provincia Autonoma di Trento, Umbria, Veneto) dhe Sllovenia

4 vende jo-anëtare të BE-së: Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia.

EUSAIR është ndërtuar mbi katër shtylla tematike:

- 1) Rritja blu
- 2) Kapaciteti lidhës i rajonit
- 3) Cilësia e mjedisit
- 4) Turizmi ekologjik

Gjithashtu, ekzistojnë dy çështje që mbulojnë disa fusha:

- Kërkimi, inovacioni dhe NVM-të
- Ndërtimi i kapaciteteve, duke përfshirë komunikimin

Secila shtyllë u adresohet temave të mëposhtme specifike:

RRITJA BLU:

- Teknologjitë blu
- Peshkimi dhe akuakultura
- Administrimi dhe shërbimet bregdetare dhe detare

KAPACITETI LIDHËS I RAJONIT:

- Transporti detar
- Lidhjet intermodale me zonat në brendësi të vendit
- Rrjetet e energjisë

CILËSIA E MJEDISIT:

- Mjedisi detar
- Biodiversiteti dhe habitatet tokësore trans-kombëtare

TURIZMI EKOLOGJIK:

- Oferta e diversifikuar e turizmit
- Menaxhimi ekologjik dhe i përgjegjshëm i turizmit



EU Strategy
for the Adriatic
and Ionian Region
EUSAIR

REZULTATET E ARRITURA DERI TANI

EUSAIR është duke marrë formë që prej prezantimit të tij në vitin 2014. Fillimisht puna është fokusuar pikësisht në ngritjen e strukturave efikase të qeverisjes dhe të procedurave të bashkëpunimit që nevojiten për të ekzekutuar dhe çuar përpara Strategjinë. Aktualisht, vendet pjesëmarrëse po punojnë drejt promovimit të masave, projekteve dhe proceseve makro-rajonale të favorshme për arritjen e objektivave të Strategjisë. Në njëfarë mase, Strategjia po kontribuon që tani në një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë mes vendeve në fjalë.

DISA PREJ SHEMBUJVE KONKRETË PËRFSHIJNË:

- Bashkëpunimi mes vendeve të BE-së rreth çështjeve me interes të përbashkët me EUSAIR po i ndihmon vendet e Ballkanit Perëndimor që marrin pjesë në Strategji me procesin e integritimit të tyre në BE;
- Me qëllim arritjen e rritjes ekonomike ekologjike që respekton mjedisin, janë identifikuar korridoret e gjelbra/blu që lidhin tokën me detin Adriatik dhe Jon si pika kyçe ku duhet të promovohen projekte strategjike.



A E DINIT SE:

- Në zonën e Adriatikut dhe Jonit ka rreth 70 Monumente të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s (mbi 25 në rajonet italiane dhe 18 në Greqi), që përbëjnë rreth 15% të të gjitha monumenteve të UNESCO-s në Evropë¹.
- Mes 30 destinacioneve kryesore turistike në BE për vitin 2015, 7 rajone ndodhen në zonën e Adriatikut dhe të Jonit: 4 në Itali, 2 në Greqi dhe 1 në Kroaci².
- Baseni detar Adriatiko-Jonian, një rrugë ujore natyrore që depërton thellë në BE, ofron itinerarin më ekonomik detar nga Lindja e Largët përmes Suezit, duke e bërë distancën e udhëtimit drejt tregjeve të Evropës Qendrore 3000 km më të shkurtër sesa përmes porteve veriore. Kjo gjë ofron një potencial për një kapacitet lidhës të përmirësuar tokë-det dhe transport intermodal, duke rritur aftësinë konkurruese të ekonomive në zonat në brendësi të vendit.

MË SHUMË INFORMACION

Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian:
www.adriatic-ionian.eu/



@RegioInterreg, @EU_Regional

© Bashkimi Evropian, 2018

Ripërdorimi autorizohet me kusht që të bëhet i ditur burimi.

1) Burimi: UNESCO: <http://whc.unesco.org/en/list>

2) Burimi: Eurostat: <http://ec.europa.eu/eurostat/documents/2995521/8107715/4-07072017-AP-EN.pdf/1270c628-49df-44c0-826b-dbd99ce79961>